

Fejton: ”Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” (2)

Akuzat e rrejshme serbe kundër Izetbegoviqit

Shenja kryesore që tregon se ai ishte më shumë një nacionalist boshnjak sesa që ishte fundamentalist islamik, ishte refuzimi i tij që të jetësojë agjendën fundamentaliste islamike kur e kishte këtë mundësi

Një nga fushatat më efektive të propagandës gjatë luftës ishin akuzat e bëra nga liderët nacionalistë serbë se lideri i Bosnjës, Alija Izetbegoviq, ishte një mysliman fundamentalist që do t'i shtypte serbët. Pas një shqyrtimi të gjerë të punimeve dhe karrierës së Izetbegoviqit, raporti “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” konkludon se pohimet e tilla - të përhapura tej mase - ishin të padrejta. Edhe pse Izetbegoviqi në rininë e tij ka qenë pjesëmarrës në grupet nacionale islamiste dhe veprimet e tij tregonin se ai ishte një mysliman i devotshëm, raporti i ekspertëve thotë se është e saktë të thuhet se ai ishte një forcë e modernizimit të islamit dhe jo e fundamentalizmit të tij. Derisa Izetbegoviqi përkrahte një kthim në parimet morale të Islamit, objektiva e vërtetë e tij ishte inkurajimi i modernizimit të botës islame përmes përkushtimit ndaj bazave etike të besimit islam dhe përmes etikës së njëjtë të punës të cilën ai e ka vërejtur se ka sjellë sukses në Perëndim. Edhe pse Izetbegoviqi ka bërë shumë pak deklarime që i kanë dhënë popullatës serbe arsye për t'u brengosur, shenja kryesore që tregon se ai ishte më shumë një nacionalist boshnjak sesa që ishte fundamentalist islamik ishte refuzimi i tij që të jetësojë agjendën fundamentaliste islamike kur e kishte këtë mundësi. Kështu, raporti konkludon se nuk është e drejtë të thuhet se

Izetbegoviqi paraqiste kërcënim për serbët e Bosnjës - një akuzë kjo që është bërë vazhdimisht.


Përgjegjësia e Milosheviqit, Karaxhiqit dhe Tuxhmanit

Raporti “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” po ashtu trajton lidshpinin e Radovan Karaxhiqit, Franjo Tuxhmanit dhe Slobodan Milosheviqit. Karaxhiqi është karakterizuar si një nacionalist kokëfortë dhe i ngushtë serb, i cili dëshironte që serbët të marrin me forcë atë që ai e konsideronte të jetë e tyre. Vëmendja e madhe me të cilën qëndrimet e tij radikale kanë përfshirë partinë, shfaqet nga fakti se qysh më 1991 një takim i pajtimimit ndëretnik në Bosnje ka dështuar për shkak të qëndrimit të ashpër të pjesëmarrësve serbë. Sipas raportit “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)”, Tuxhmani ka dhënë një lidshpin të ashpër për ndjekjen e qëllimeve të ngushta nacionaliste që i kanë tëhuajësuar serbët e Kroacisë dhe bashkësinë ndërkombëtare. Milosheviqi, sipas raportit, ishte lideri më kompleks dhe më i aftë. Jo një nacionalist për kah bindja, ai iu kthye nacionalizmit për ta përdorur në atë që duket të ketë qenë qëllimi i tij kryesor: marrja dhe ruajtja e

pushtetit. Një nga metodat e tij ishte kontrolli i mediave, që prodhoi raporte nxitëse dhe tendencioze (sikur që ka ndodhur me mediat e Tuxhmanit në Kroaci). Sipas raportit, edhe pse armiqësitë etnike nuk janë pasojë vetëm e këtij lidshpini, Milosheviqi, Karaxhiqi dhe Tuxhmani megjithatë bartin barrën e përgjegjësisë.

Vendimet kontradiktore të Komisionit të Badinterit

Kur armiqësitë shpërthyen, fuqitë evropiane, që kishin fituar vetëbesimin nga rënia e komunizmit në Evropën Lindore, procesi i krijimit të Bashkimit Evropian dhe bashkimi i Gjermanisë, mendonin se mund të trajtojnë problemin, përkundër injorancës së liderëve të tyre për rrethanat në ish-Jugosllavi. Shtetet e Bashkuara u mbajtën anash. Momenti kryesor në negociatat e udhëhequra nga lordi Peter Carrington në Konferencën për Jugosllavinë erdhi në tetor-nëntor 1991. Në atë moment, pesë nga gjashtë republikat/shtetet e pranuan projekt-propozimin që i zotonte ato ndaj “standardeve universale, objektive” për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe garantimin e kufijve. Serbia e refuzoi planin, duke besuar që bashkësia ndërkombëtare në fakt nuk do të mund të mbronte të drejtat e serbëve në Kroaci dhe Bosnjë.



Alija Izetbegoviq nuk ka qenë fundamentalist islamik siç e akuzonin serbët

Pika e fundit që trajtohet në raportin “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” janë vendimet e ndryshme të Komisionit të Badinterit, sikur që është ai se Jugosllavia është në procesin e shpërbërjes, prandaj Sllovenia dhe Kroacia nuk po shkëputeshin, dhe se serbët e Kroacisë ishin minoritetet dhe rrjedhimisht ligji ndërkombëtar nuk u lejon shkëputje. Sipas raportit, Komisionit të Badinterit i është dashur të bëjë atë që ishte e mundur në një situatë të dhunshme dhe atë për një kohë të shkurtër. Në afat të gjatë, një nga pasojat negative të punës së këtij komisioni janë shfaqja e kontraditave mes të drejtës për vetëvendosje dhe nevojës për t'i mbajtur kufijtë shtetërorë.

(Nesër: Si e ka trajtuar çështjen e minoriteteve Jugosllavia socialiste? Cili ishte aspekti origjinal i zgjidhjes së çështjes minoritare në RSFJ?)



Al Capone - vetëm 25-vjeçar u bë tmerr e panik i Chicagos

Fejton: “Al Capone: Kumbara i nëntokës” (5)

Gjaku i nxehtë

Al Capone sapo e kishte varrosur të vëllain dhe ende ishte duke mbajtur zi, kur një bandit i vocërr, i quajtur Joe Howard, e bëri gabimin e tij më të madh në jetë: vendosi t'i përzihej në biznes Capones. Al Capone nuk pyeti as qysh as pse, vetëm ia numëroi gjashtë copa në trup Howardit

Kur Franki Yale e kishte vrarë Jim Colosimon, Chicagoja kishte mbetur pa mbret të nëntokës. Johnny Torrio e kishte shfrytëzuar këtë vakuum për ta marrë pushtetin. Në këtë tollovi, Torrio e kishte marrë me vete 22-vjeçarin Al Capone dhe e kishte angazhuar në punët e veta. Më 1921, Al Capone ua kishte kthyer shpinën punëve të pastra dhe kishte nisur të merrej vetëm me punë të pista. Capone kishte mësuar nga Torrio si të punonte me mend dhe kishte mësuar nga Franje Yale si të punonte me muskuj. Të dy stilet i kishte zotëruar mirë. Shumë shpejt u bë dorë e djathtë e Torrios dhe menaxher i lokalit “Four Deuces”. Ky lokal ishte edhe kazino, edhe shtëpi publike në të njëjtën kohë. Al Capone po e udhëhiqte mirë lokalin. Në këtë kohë ai u shoqërua me njëfarë John Guziku. Guziku ishte hebre dhe merrej me udhëheqje të prostitucionit. Mirëpo, ishte edhe njeri familjar. Ai u bë si vëlla i madh i Capones. Capones nuk i bënte përshtypje që Guzik nuk ishte italian. Lokali po i sillte shumë para Capones dhe ai e bleu një shtëpi për veten dhe familjen në Chicago. Në atë familje jetonin grua e tij Mae, djali Albert, të cilin e quanin Sony, si dhe nëna me të gjithë vëllezërit e motrat e tij. Familja e tij nuk e bënte të madhe punën e Alit. Thoshin se punonte si shef në një uzinë. Fqinjët e konsideronin burrë të

mirë. “Sa më thellë që hynte në biznese të pista, si reketimi, aq më shumë lidhej me familjen”, thotë për Al Caponen, historianja Bergreen. “Al Capone nuk ka qenë një monstër siç shkruanin gazetatat për të më pas”. Megjithatë, disa nga bëmat e tij e tregojnë si monstër e gjysmë. Për disa vjet në Chicago gjithçka kishte qenë e qetë dhe pastaj një gangster i quajtur William Dever arriti ta korruptonte prefektin e qytetit Bill Thompsonin. Kjo ua komplikoi punën gangsterëve të tjerë. Torrio dhe Capone nisën të punonin më shumë në periferi. Mirëpo, ndërkohë Torrio vendosi të kthehej në Itali dhe të gjithë biznesin ia la në dorë Capones. Capone e kishte shtrirë biznesin në vendin e quajtur Cicero në periferi të Chicagos. I vetmi që i prishte punë ishte gazetari Robert St John, i cili gati çdo javë nxirrte ndonjë artikull, ku tregonte për Caponen si njeri që bën reket dhe punë të pista. Capone, madje përzihej edhe në punë të qeverisë. Në mes tjerash, kidnapoi kandidatët për prefekt të qytetit. Shefi i policisë së Chicagos zgjodhi 79 burrat më të mirë që i kishte, ua dha nga një çifte dhe u dha urdhër të bastisnin në Cicero. Në udhë u doli vëllai i Al Capones, Franko. E vranë. Ali u tërbua fare. Al Capone e varrosi të vëllain në një funeral që nuk do të harrohet kurrë - me shumë lule. Në kohën kur ende po mbante zi për

Gangsterë të tjerë të shquar

Joseph Valachi

Joseph Valachi nuk ka qenë ndonjë anëtar i lartë në hierarkinë e mafias. Mirëpo, është bërë i famshëm për diçka tjetër: ka guxuar të dalë e të dëshmojë kundër mafias, kundër “Cosa Nostras”. Valachi ka qenë anëtar i grupit të Salvatore Maranzanos që në vitet njëzet të shekullit XX dhe ka pranuar që për ë gjitha të dëshmonte më 1953 para një komisioni të Senatit. Dëshmia e tij nuk e futi drejtpërdrejt në burg asnjë mafioz të madh. Mirëpo, në bazë të fakteve që i kishte treguar ai, më pas u arrestuan jo më pak se 30 nga personat më të rëndësishëm të nëntokës.

vëllain, një bandit i vocërr, i quajtur Joe Howard, nisi t'i përzihej në biznes. Capone posa e takoi Howardin, as nuk e pyeti qysh e pse, vetëm ia numëroi gjashtë plumba në trup. Prokurori William McSwiggin vendosi ta ndiqte Caponen. Mirëpo, askush nuk dëshironte të dëshmonte kundër Capones. Në moshën 25-vjeçare, dhe pas vetëm katër vjetësh në Chicago, Al Capone u bë emër që t'i fuste të dridhurat në trup. Kishte para, kishte pushtet dhe kishte emër që i bënte të tjerët të frikësoheshin. Mirëpo, paqja që e kishte vendosur Johnny Torrio me urtinë e tij, tashmë ishte prishur në nëntokën e Chicagos.

(Në numrin e ardhshëm: Kush ishte Dion O'Banon? Si hyri në burg Johnny Torrio? Funerali i kujt u kremtua si dasmë? Kush po bëhej gati për të marrë hak?)